

Ndërmarrjet e Huaja në Shqipëri

Periudha 2017-2019

Tiranë, më 24Dhjetor 2020: Publikimi “Ndërmarrjet e huaja në Shqipëri”, përmban informacion mbi treguesit kryesorë të ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët që operojnë në Shqipëri, për vitet referencë 2017-2019.

Në vitin 2019 ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë 6.443, ndërsa në fund të vitit 2018 dhe 2017 ishin përkatësisht 6.259 dhe 6.295. Peshën më të madhe të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta e japin Italia dhe Greqia në të tre treguesit e marrë në analizë, 53,4 % të ndërmarrjeve; 60,9 % të punësimit; 53,5 % të eksporteve dhe 49,2 % të importeve.

Në periudhë kohore 2017-2019 ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Bashkimit Evropian zënë mesatarisht 65,6 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, ndërsa shtetet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë 10,9 % të këtyre ndërmarrjeve.


Në ekonominë shqiptare, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta nga Shtetet e Bashkimit Evropian janë mbizotëruese në aktivitetet: shërbime të tjera (25,1 %), tregti (15,8 %) dhe industri (10,9 %).

Në periudhën kohore 2017-2019, ndërmarrjet nga vendet e BE-së me 1-9 të punësuar mbulonjnë 85,1 % të të gjitha ndërmarrjeve të BE-së, ndërsa ndërmarrjet me 250+ të punësuar mbulojnë 1,2 %.

Treguesit kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta

Në vitin 2019, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 16,1 % të punësimit gjithsej nga 15,6 % dhe 18,7 që zinin në vitin 2018 dhe 2017. Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta përbëjnë 20,5 % të shitjeve neto të ndërmarrjeve gjithsej në vitin 2019, ndërsa gjatë 2018 dhe 2017 ky tregues ishte 25,8 % dhe 30,3%. Përqindja e investimeve të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta është 30,0 % e investimeve gjithsej të vitit 2019, ndërsa në vitet 2018 dhe 2017 ishte 25,0 % dhe 30,4%,

Fig.1 Treguesit kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët ndaj ndërmarrjeve shqiptare, 2017-2019



Burimi:INSTAT

Tregtia e jashtme e mallrave sipas Ndërmarrjeve

Në harkun kohor 2017-2019, eksportet e mallrave të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta përbëjnë mesatarisht 50,4 %, të eksporteve të mallrave gjithsej. Ndërsa importet e mallrave këtyre ndërmarrjeve përbëjnë mesatarisht 27,0 %, të importeve të mallrave gjithsej.

Investimet e Huaja Direkte (IHD)

Stoku i Investimeve të Huaja Direkte është rritur me 26,2 % në 2019, krahasuar me 2017. Në fund të vitit 2019, vendet e BE-së përbëjnë pjesën më të madhe të Stokut (55,3 %), të dominuara nga Holanda dhe Italia respektivisht me 15,3 % dhe 9,4 %.

Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte është rritur me 5,2 % në 2019, krahasuar me 2018. Për 2019, Italia ka patur rritjen më të madhe me gati 2 herë ndërsa Zvicra rënien më të madhe me 44,6 %, krahasuar me 2018.

Tab.1 IHD, Stoku dhe Flow sipas vendeve (mil Euro)

Investimet e Huaja Direkte	Stoku			Fluksi		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019
Gjithsej	6.456,1	7.602,8	8.147,5	899,9	1.019,6	1.072,3
<i>BE-28</i>	3.672,2	4.155,3	4.508,5	351,2	420,5	586,5
Austria	447,5	505,0	545,8	55,0	56,1	43,4
Britania e Madhe	51,2	62,1	78,5	9,0	7,9	17,5
Gjermania	111,5	148,5	147,1	-20,4	21,2	19,1
Greqia	1.216,8	1.149,0	500,2	27,2	-27,8	-9,2
Italia	610,1	699,2	764,8	61,6	52,9	118,8
Hollanda	826,8	1.007,2	1.245,4	-	-	-
Të tjera EU	408,2	584,3	1.226,9	218,8	310,1	396,9
Zvicra	893,7	1.315,8	1.495,2	338,6	354,9	196,7
Kanada	883,8	1.000,6	1.115,2	149,1	83,4	112,8
SH. B.A.	79,1	102,8	81,8	3,3	13,7	20,0
Të tjera	927,3	1.028,3	946,7	57,7	147,1	156,3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Metodologjia

INSTAT realizoi botimin e statistikave të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë. Ky botim përmban statistika nga sektorë të ndryshëm të dy institucioneve.

Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Për më shumë informacion metodologjik referohuni link-eve:

Regjistri Statistikor

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABrmarrjeve/>

Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-strukturore-t%C3%AB-nd%C3%ABrmarrjeve-ekonomike/>

Banka e Shqipërisë

[Investimet e huaja direkte \(bankofalbania.org\)](http://www.bankofalbania.org)

Statistikat e Tregtisë së Jashtme

<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/>

Përkufizimet kryesore

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.